



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 46/12

Prishtinë, më 25.01.2012, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Muhamet Mustafa, Duda Balje dhe Xhevdet Neziraj.

Mungoi: Hykmete Bajrami.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza, Ministër i Financave, Rejhane Zylfijaj, Ramadan Islami, nga GIZ, monitorues OSCE, KDI.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite

1. Miratimi i rendit të ditës;
 2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës; I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat; I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
 4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale; I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
 5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-162 për tatimin në të ardhurat e korporatave; I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
 6. Shqyrtimi i Projektligjit 04/L-88 për Arkivat me Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media;
 7. Të ndryshme.
1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, theksoi se përmes stafit jeni njoftuar në formë elektronike për raportin me amendamentet të komisionit funksional për Projektligjin për Transmetimin Publik në Kosovë, i cili është riproceduar për shqyrtim në komisionet e përhershme për shkak të ndryshimit të amendamenteve. Propozoi që kjo pikë të jetë për shqyrtim si pika shtatë e rendit të ditës.

Rendi i ditës njëzëri u miratua me plotësime, shtohet pika e 7 e rendit të ditës: Rishqyrtimi Projektligjit nr.04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë me raportin me amendamente të komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, ndërsa pika 7 bëhet pika e 8 e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës

Kryetarja, theksoi se sa herë që është diskutuar në parlament për çështjen e pensioneve, kemi kërkuar që të hartohet projektligji, i cili tashmë është draftuar dhe është proceduar për miratim në Kuvend nga Qeveria. Nëse e analizojmë projektligjin shohim se çështjet kryesore që kanë të bëjnë me sistemin pensional janë të përfshira në këtë projektligje. Janë rregulluar pensionet bazë dhe pensionet e kursimeve individuale, fondet plotësuese pensionale dhe pensionet plotësuese individuale. Përmes projektligjit përcaktohet edhe licencimi, rregullimi, mbikëqyrja dhe investimi i mjeteve pensionale, si dhe përcaktohen standardet e nevojshme për zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sistemit pensionale, sigurohet mbrojtja e pjesëmarrësve dhe të mjeteve pensionale.

Bedri Hamza, theksoi se me qëllim të avancimit të infrastrukturës ligjore ekzistuese për licencimin mbikëqyrjen dhe rregullimin e fondeve pensionale, duke e siguruar mbrojtjen e pjesëmarrësve pensional në Kosovë, si Ministri e Financave kemi hartuar draftligji për fondet pensionale, i cili vlerësojmë se është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Çështjet kryesore të adresuara në këtë projektligj janë pensionet bazike, pensionet e kursimeve individuale dhe të detyrueshme, fondet plotësuese pensionale dhe pensionet plotësuese individuale. Projektligji po ashtu rregullon edhe mënyrën e investimeve të mjeteve pensionale, duke përfshirë edhe mundësinë dhe përqindjen e investimeve të letrave me vlerë të qeverisë së Kosovës. Karakteristikë me këtë projektligj është se nga 5% sa ka qenë mundësia e investimit të mjeteve të fondit të investohen në Kosovë, kjo përqindje është ngritur në 30%, duke përcaktuar të drejtën bordit të trustit që të vendose për investimin e mjeteve. Projektligji është pjesë e marrëveshjes me FMN dhe i harmonizuar me Bankën Qëndrore.

Muhamet Mustafa, vlerësoi se është për tu përshëndetur iniciativa për miratimin e këtij ligji dhe me këtë po krijohet mundësia e absorbimit të një shumë të konsiderueshme të investimit të mjeteve të fondit në Kosovë. Projektligji siguron dhe krijon parakushte për investimin në projekt të cilat do të ndikojnë në një kthim më të madhë të mjeteve pensionale. Krahës kësaj ne do të krijojmë praktikën që na mundësojnë që investimet nga fondi të jenë të kujdesshme dhe për këtë qëllim duhet kërkojmë ngritjen e aftësive profesionale të administratës së trustit dhe një angazhim të BQK-së në mbikëqyrjen e investimit të këtyre mjeteve me një siguri më të madhe kthimi. Lejimi i mundësisë së investimit prej 30%, mendojë se është hap i mjaftueshëm për këtë moment dhe krijon një portfolio optimale në investime në tregun financiar të Kosovës dhe jashtë. E mbështes miratimin e projektligjit në parim.

Naser Osmani, theksoi se deputetë vazhdimisht kanë kërkuar që të shfrytëzohen mjetet e fondit pensional në Kosovë, që deri me tani ka qenë pengesë baza ligjore për të bërë një gjë të këtillë, ka pasur kërkesa të mjaftueshme financiare për rigjenerimin dhe krijimin e të mirave të dyfishta të këtyre mjeteve. Ju përgëzojmë për hapin për rritjen e mundësisë së investimeve në tregun e Kosovës në 30% dhe besojë se edhe deputetë tjerë do të mbështesin një propozim të këtillë.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit, miratimin në parim të Projektligjit nr. 04/L-101 për fondet pensionale të Kosovës.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat

Naser Osmani, vlerësoi se deri më tani kemi pasur një ligj të mirë për ATK dhe një performancë të mirë të Administratës Tatimore, si një shtyllë e rëndësishme e shtetit në mbushjen e arkës buxhetore.

Bedri Hamza, sqaroi se qëllimi kryesorë i ndryshimit të këtij ligji është rregullimi dhe funksionaliteti i Bordit të Pavarur për Rishqyrtime, i cili është ballafaquar me vështërsi të natyrave të ndryshme që ka rezultuar edhe në mungesën e rezultateve të dëshiruar dhe në kohë në zgjidhjen të ankesave tatimore dhe doganore. Statusi i pazgjedhur i këtij bordi është identifikuar edhe në Raportin e Progresit, që ka ndikuar në vonesat ligjore për zgjidhjen e ankesave ndaj bizneseve. Me asistencën e Zyrës ndërlidhëse të Komisionit Evropian në projektligj kemi vendosur bazën ligjore për themelimin e divizionit fiskal, i cili do të jetë në kuadër të departamentit të ankesave të Gjykatëse qendrore në Prishtinë. Qëllimi ynë është që me hyrjen në fuqi të ligjit për gjykata në janar të viti 2013, të funksionalizohet divizioni i ankesave ku në të ardhmen ankesat ndaj doganave, administratës tatimore, departamentit të tatimit në pronë, të bëhen nga gjykatësit të cilët është paraparë që të zgjedhën gjatë viti 2012, nga Këshilli i Gjyqësorë i Kosovës.

Muhamet Mustafa pyeti pse po shtyhet aplikimi i ligjit deri në vitin 2013?

Latif Gashi pyeti se do të ketë projektligji implikime më të mëdha financiare, se sa që është e paraparë në deklaratën financiare për vitin 2013?

Bedri Hamza, sqaroi se aplikimi i ligjit në vitin 2013 është paraparë për të mundësuar krijimin e bazës ligjore për zgjidhjen e gjymëtarëve, trajnimi i tyre dhe të startojmë në vitin 2013 në shqyrtimin e ankesave nga njerëzit kompetent dhe profesionist. Sa i përket implikimeve buxhetore, fondi i propozuar do të jetë i mjaftueshëm.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit, miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat

4 Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale

Bedri Hamza, qëllimet e ndryshimit të projektligjit është përcaktimi i normës së tatimit për të ardhurat e personave që punojnë në shërbime dhe veprimtaritë profesionale e të zanatit, të argëtimit dhe të

ngjajshëm, si janë profesionistët, avokatët, kontabilistët dhe mjekët, të cilët përkundër faktit se realizojnë të ardhura mbi 450€ kanë paguar tatim 5% dhe tani është planifikuar të paguajnë 9 % bruto apo 37.5% për çdo 3 muaj . Deri të ngritja për këto kategori ka ardhur për eliminimin e diskriminimit për personat që paguajnë tatime sipas normave të përcaktuara. Norma e propozuar është harmonizuar me FMN dhe komunitetin e biznesit. Ndërkaq punëtorët që paguhën përmes buxhetit të shtetit dhe ata në biznese private paguajnë tatim në shkallët e caktuar më herët me ligj.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit, miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për tatimin në të ardhurat personale.

5 Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-162 për tatimin në të ardhurat e korporatave

Bedri Hamza, edhe më këtë projektligj është paraparë që kategoria e profesionistëve a dëshirojnë të paguajnë tatime në të ardhura individuale apo tatime mbi të ardhurat reale në fitim të korporatave. Tatimpaguesit e një korporate, ndërmarrje private apo shoqëri tregtare dhe një OJQ dhe veprimtarit, taten për të ardhurat bruto të realizuara nga shërbimet e veprimtarisë profesionale, të zanatit, të argëtimit dhe të ngjashme, dhe paguajnë 9% bruto apo 37.5% për çdo tre muaj. Qëllimi është eliminimi i diskriminimit në pagesën e tatimeve.

Sali Asllanaj, pyeti sa do të jetë përfitimet buxhetore, nga ndryshimet në ligjet në të ardhurat personale dhe të korporatave?

Bedri Hamza, sipas përlllogaritjeve që kemi bërë, efekte shtesë në ndryshimin e këtyre projektligjeve në buxhetin e Kosovës do të jetë 1.5 a po deri në 2 milion euro në vit. Qëllimi kryesorë i ndryshimeve është trajtimi i barabartë i të gjithë atyre që paguajnë tatime, pavarësisht nga të ardhurat e realizuara.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Kuvendit, miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-161 për tatimin në të ardhurat e korporatave.

6. Shqyrtimi i Projektligjit 04/L-88 për Arkivat me Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike

Komisioni njëzëri nxori këtë:

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e propozuara nga komisioni funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

7. Rishqyrtimin i Projektligjit per Transmetuesin Publik ne Kosove me Raportin me amendamentet të Komisionit funksional per Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Kryetarja, njoftoi se projektligjin në fjalë së bashku me amendamentet e komisionit funksional e ka shqyrtuar dhe ka nxjerrur raportin me rekomandime lidhur me implikimet buxhetore. Mirëpo komisioni funksional ka punuar përsëri në amendamentimin e tij dhe ka harmonizuar qëndrimet me zyrën e komisionit evropian për disa ndryshime që në raportin e parë nuk ka qenë. Meqenë se disa nga amendamentet e propozuar kanë ndërlidhje me çështjet buxhetore dhe financiare, për të cilat është komentet komisioni për Buxhet dhe Financa dhe disa propozime nuk janë në harmoni me legjislacionin që kemi në fuqi, është e nevojshme që të analizohen më në detale dhe për këtë qëllim në konsultim me zëvendëskryetarin e parë, kemi menduar që të krijojnë një grup punues. Për grupin punues propozojë Naser Osmani, Latif Gashi dhe Duda Balje.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

- I. Shtyhet shqyrtimi i Projektligjit per Transmetuesin Publik ne Kosove me Raportin me amendamentet të Komisionit funksional per Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.
- II. Caktohet grupi punues në përbërje të Naser Osmani, Latif Gashi dhe Duda Balje, për shqyrtimin e amendamenteve të komisionit funksional dhe në afatin më të shpejtë ti paraqet komisionit raportin me rekomandime.

8. Të ndryshme

Kryetarja, njoftoi për pjesëmarrjen e saj në takimin e Kryetarit të Kuvendit me kryetarët e komisioneve parlamentare, ku është kërkuar që të gjitha komisionet deri më 31 janar duhet përgatisin planet vjetore të punës. Ne jemi në proces të përgatitjes së draft planit të punës dhe shpejtë do të jetë i gatshëm dhe do të merrni secili. Njoftoi se takimi për shqyrtimin e draft planit të punës së Komisionit për vitin 2012, do të mbahet më 27.01.2012, prej ora 10:00, në ndërtesën e GIZ, ku do të mbahet një takim i përbashkët me GIZ për të harmonizohen qëndrimet dhe planifikimet e përbashkëta për këtë vit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona